

Komuna e Gllgocit/Glogovac

Sejdi (Sadik) Muja

(3.02.1946, shqiptar nga Gradica, komuna e Gllgocit/Glogovac, pylltar, njëmbëdhjetë fëmijë)

Sejdiu jetonte me familjen e vet në **Gradicë/Gradica**, ndërsa punonte në degën e ndërmarrjes *Srbijašume* në Gllgoc/Glogovac. Ishte i ngarkuar me mbikëqyrjen e pyjeve në bjeshkën e *Çiçavicës/Čičavica*. Në datën **12.01.1998**, si zakonisht rreth orës 8:45, ai u nis në punë së bashku me komshiuin Selim Dibrani. Në çastin kur kalonin nëpër *Mëhallën Dibrani* dhe kur ishin pranë shtëpisë së Lutvi Dibranit, para tyre dolën tre burra të veshur në rroba civile, me maska në fytyrë dhe të armatosur me pushkë automatike. Selimit iu drejtuan në shqip, duke i urdhëruar që të vazhdonte rrugën dhe mos ta kthente shikimin prapa. Më pas, shtënën dhe e vranë Sejdiun në vend. Po atë ditë, policia serbe e ka kryer hetimin në vendngjarjen e vrasjes dhe e ka çuar trupin e Sejdiut në Institutin për Mjekësinë Ligjore në Prishtinë/Priština. Të nesërmen, djemtë e Sejdiut e kanë marrë kufomën e të atit dhe e kanë varrosur në varrezat e fshatit të lindjes së Gradicës/Gradica.

Burimet: deklarata D.M, FDH-1152; deklarata S.M, FDH-32014; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.D290.15, FDH-30801; SMIP, *Teroristički...*, III, 909; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Rexhep (Hamit) Rexhepi

(26.12.1965, shqiptar nga Korrotica e Poshtme/Donja Koretica, komuna e Gllgocit/Glogovac, tregtar, dy fëmijë)

Në datën **12.02.1998**, Rexhepi po kthehej në shtëpi në fshatin **Korroticë të Poshtme/Donja Koretica**, së bashku me djalin e axhës, Shaniun, i cili ishte pjesëtar i UÇK-së. Ata po ktheheshin me traktor nga Pokleku i Ri/Novi Poklek. Kur iu afruan shtëpisë jo më larg se 30 metra, një veture policore e tipit *Pinzgauer* doli para traktorit. Një nga policët i urdhëroi Rexhepin që të zbriste nga traktori. Pasi e legjitimoi, ai i ka shtënë përpara këmbëve. Shaniu tentoi të shfrytëzonte këtë situatë që të largohej drejt shtëpisë, por një polic tjetër e ndaloi dhe e legjitimoi. Në atë çast, polici i parë prapë ka shtënë duke e vranë Rexhepin në vend. Shaniu e ktheu zjarrin, por u tërhoq duke mos mundur që ta merrte me vete trupin e pajetë të Rexhepit. Po atë ditë, vëllai dhe axha i Shaniut kanë shkuar dhe e kanë marrë trupin e Rexhepit. Por, së shpejti sërish erdhën policët serbë, e morën dhe e çuan trupin e Rexhepit në Gllgoc/Glogovac. Dy ditë më vonë dhe pas ndërmjetimit të Misionit të OSBE-it, familjarët e kanë marrë trupin e Rexhepit dhe e kanë varrosur në varrezat e Poklekut të Ri/Novi Poklek. Pas mbarimit të luftës, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Rexhepit në varrezat e Korroticës së Poshtme/Donja Koretica.

Burimet: deklarata S.R, FDH-17981; SMIP, *Teroristički...*, III, 617; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Mustafa (Rexhep) Kurtaj

(15.01.1971, shqiptar nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Gllgocit/Glogovac, postier, dy fëmijë)